



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.3.2023

Nr: 170

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “BINDJA DEMOKRATIKE”, PËR REGJISTRIMIN SI  
SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ  
2023**

Sot më datë 11.3.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1313 Prot., datë 3.3.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Bindja Demokratike”, me kryetar z. Astrit Patozi.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Bindja Demokratike” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Bindja Demokratike” ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.



Pranë KQZ-së është depozituar kërkesa me nr. 1313/1 Prot., datë 6.3.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit ka rezultuar se kërkesa ka paqartësi pasi në hyrje të saj ka të përcaktuar si kryetar partie z. Astrit Patozi dhe në përmbajtjen e saj rezulton se kryetar i partisë politike “Bindja Demokratike” është z. Fabian Topollari. Po kështu rezulton se, deklaratën e hapjes së llogarisë së posaçme e ka nënshkruar z. Fabian Topollari.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 24.2.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Bindja Demokratike”, me iniciale “BD”, me kryetar të përkohshëm është z. Astrit Patozi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Bindja Demokratike” me shkronja nistore “BD”, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Bllok, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Astrit Patozi, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Bllok, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Suzana Gina, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Bllok Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Fabian Topollari, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani” Bllok Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Nisur nga sa më sipër, me vendimin nr. 155, datë 9.3.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pas verifikimeve përkatëse konstatoi se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga partia “Bindja Demokratike”, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, të Kodit Zgjedhor.

Partia politike “Bindja Demokratike” në përmbushje të afatit kohor (24 orë) të parashikuar në vendimin si më sipër, ka paraqitur kërkesën/dokumentacionin e plotësuar. Kërkesa është paraqitur nga kryetari z. Astrit Patozi (sipas vërtetimit të zyrës së regjistrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Gjatë seancës publike, z. Fabian Topollari është shprehur se kryetari i partisë Bindja Demokratike është ai dhe jo z. Astrit Patozi.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, kërkesa dhe dokumentacioni i plotësuar i paraqitur nga partia politike “Bindja Demokratike” me kryetar z. Astrit Patozi, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## VENDOS:

1. Regjistrimin e partisë politike “Bindja Demokratike”, me Kryetar z. Astrit Patozi, me shkronjat nistore “BD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**